VENDIM
Nr. 18, datë 11.2.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "POWER ELEKTRIK SLLABINJE" SHPK NË AKTIVITETIN E FURNIZUESIT TË KUALIFIKUAR TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 3, pika 31; 8 pika 2, germa "a"; 9 dhe nenit 45 pika 4 dhe 48 pika 2, të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, neneve 4 pika 1 germa "f"; 5 pika 1 germa "f"; 13 dhe 14 pika 1, të "Rregullores për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 108 datë 9.9.2008, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 11.2.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit dhe Monitorimit të Tregut dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mbi Licencimin në aktivitetin e Furnizuesit të Kualifikuar të Energjisë Elektrike,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në "Rregulloren për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë /të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3) është plotësuar tërësisht.
- Dokumentacioni teknik (neni 9, pika 4.9 germat "a", "b", "c") janë paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, cituar Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë "Power Elektrik Sllabinje" sh.p.k., në aktivitetin e furnizuesit të kualifikuar të energjisë elektrike, për një afat 5- vjeçar.
2. Ngarkohet Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të Komsionerëve të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit Ahmeti